VENDIM
Nr. 461 , datë 27.5.2015

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR MINISTRINË E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE, DHE PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NDËRMJET PROGRAMEVE TË MIRATUARA PËR KËTË MINISTRI, PËR PASTRIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E KANALEVE TË UJITJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 44 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të neneve 13 e 17, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në programin buxhetor 04240 "Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes", në artikullin 602, shtohet fondi 62 200 000 (gjashtëdhjetë e dy milionë e dyqind mijë) lekë, për pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve të ujitjes.

Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.

2. Rishpërndarjen e fondeve, ndërmjet programeve të miratuara në buxhetin e vitit 2015 për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve të ujitjes, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 04240 "Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes", në artikullin 602, shtohet fondi 5 000 000 (pesë milionë) lekë;

b) Në programin buxhetor 04860 "Këshillimi dhe informacioni bujqësor", shpenzimet e personelit pakësohen me 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama